

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“TOKË MEDICAL CENTER” sh.p.k**

Në bazë të ligjit ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, me vullnetin e tyre të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më datë 21/03/2024, Themeluesit:

1. **Znj. Klarida Begaj**, lindur në Berat, Shqiperi me 04.03.1996, banuese në Vlorë, me leternjoftim nr personal J65304082L.

Deklaron se ka vendosor të nënshkruaj këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë refereruar si Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti duke respektuar edhe kërkesat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare.

**Neni 1-Emërtimi**  
Emërtimi i shoqërisë është

**“TOKË MEDICAL CENTER” sh.p.k**

**Emri tregtar i shoqërisë : “TOKË MEDICAL CENTER” SHPK**

Ne të gjitha aktet e dokumentat që dalin nga shoqëria emertimi i saj do të paraprihet (ose do të ndiqet menjëherë) nga inicialet “SH.P.K” dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

**Neni 2-Vëndndodhja e selisë**

**Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet: SAUK, TIRANË , Pasuria me nr 98/3+1-1, ZK.3266, Pasuria me nr 98/3+1-2, ZK.3266, Pasuria me nr 98/3+1-3, ZK.3266, Pasuria me nr 98/3+1-4, ZK.3266,**

**Neni 3- Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së rregjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Rregjistrimi.

**Neni 4- Objekti i veprimtarisë**

- Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si vijon:

- a) Ofrimin e shërbimeve mjekësore parësore, stomatologjike, dermatologjike, fizioterapike, masazherike, SPA. Konsulta dhe diagnostikim mjekësor, ndërhyrje mini-invazive, mikrokirurgji b) Ofrimin e shërbimeve të mjekësisë estetike (transplant i flokëve, trajtime me lazer, botox filler, microneedling, radiofrekuenca, peeling, etj.) c) Trajtime estetike, kozmetike, parukeri; d) Importin, eksportin dhe tregtimin me shumicë dhe/ose me pakice të produkteve mjekësore apo farmaceutike, produkteve kozmetike; e) Veprimtari të publikimit dhe reklamimit në fushën e mjekësisë dhe estetikës; f) Shitjen online të produkteve/ shërbimeve që Shoqëria ofron në fushën e mjekësisë dhe estetikës. g) Menaxhimin e strukturave të hotelerisë dhe ofrimin e shërbimeve të hotelerisë, përfshirë edhe cdo veprimtari tjetër plotësuese që lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejt apo të tërthortë me veprimtarinë e menaxhimit të strukturave të hotelerisë dhe ofrimit të shërbimeve të hotelerisë; h) Ofrimin e trajnimeve dhe kurseve të formimit profesional në fushën e estetikës dhe kozmetikës;

Shoqëria mund të kryejë cdo veprimtari tjetër që, edhe pse nuk ka lidhje me sa është parashikuar më sipër, nuk përbën një veprimtari të ndaluar me ligj dhe që është në funksion të përmbushjes së objektit të Shoqërisë.

#### **Neni 5- Kapitali Themeltar**

**Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000.000 (një milion) lekë.**

Kapitali themeltar është i perbërë nga 1 (një) pjesë kapitali me vlerë nominale 1,000,000 (një) lekë.

#### **Neni 6-Kontributet dhe pjesët e kapitalit themeltar**

**1) Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000.000 (një milion) lekë.**

Kapitali themeltar është i perbërë nga 1 (një) pjesë kapitali me vlerë nominale **1.000.000 (një milion) lekë.**

Sipas kontributeve në kapitalin themeltar të shoqërisë pjesët e tij ndahen:

Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortakët e shoqërisë përkatesisht:

- Znj. Klarida Begaj**, lindur në Berat, Shqipëri me 04.03.1996, banuese në Vlorë, me letërnjoftim nr personal J65304082L vlera e kapitalit të përgjithshëm **1.000.000 (një milion) Lekë**, numri i pjesëve 1, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqesohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundërt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë

### **Neni 7- Transferimi i pjesëve të kapitalit**

1. Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

### **Neni 8- Administrimi**

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta edhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Zakonshme.
2. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.
2. **Administratori i vetëm i shoqërisë është : Znj. Klarida Begaj, lindur në Berat, Shqiperi me 04.03.1996, banuese në Vlorë, me leternjoftim nr personal J65304082L me afat 5-vjecare deri me 20.03.2029 .**

3. Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara për këtë akt dhe aktet që rrjedhin prej tij u përkasin bashkarisht dhe solidarisht nënshkruesëve në përpjestim me kontributet e tyre deri sa shoqëria të rregjistrohet në regjistrin tregtar.

### **Neni 9- Të tjera**

1. Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.

### **Neni - 10**

1. Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në menyre të drjetpërdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur me pajtim. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

### **Neni - 11**

1. Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barabarta dhe të barazvlefshme.

*Parë dhe miratuar në Tiranë, më 21/03/2024.*

## **ORTAKËT E SHOQËRISË**

**Klarida Begaj**

*Klarida Begaj*  
